



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.363/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Komuna e Glllogovc – Drejtoria e Inspektionit. paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Drenas, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor - posterëve në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 12.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa A.nr.363/2021 e datës 10.02.2021, e ushtruar nga Drejtoria e Inspektionit - Komuna e Glllogovc, ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Drenas, sa i përket kandidatëve për deputet: Petrit Hajdari, Hyrije Xhemajlaj, Donjet Bislimi, Ferat Shala, Sejdi Hoxha, Shqipe Zogaj, Besa Qeku dhe Xhevahire Izmaku, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterëve për fushatën zgjedhore neper hapësirat publike, në Komunën e Drenasit, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 12,000.00 (dymbëdhjetëmijë) euro.

II. DETYROHET Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Glllogovc, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

III. REFUZOHET e pabazuar pjesërisht ankesa A.nr.363/2021 e datës 10.02.2021, e ushtruar nga Drejtoria e Inspektionit - Komuna e Glllogovc, ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) dega në Glllogovc, ne pjesën që ka të bëjë me kandidatin për deputet: Besa Çeku, me pretendim për shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterëve për fushatën zgjedhore neper hapësirat publike, në Komunën e Drenasit.

A r s y e t i m

Drejtoria e Inspektionit - Komuna e Glllogovc, ka parashtuar ankesë A.nr.363/2021 e datës 10.02.2021, me të cilën pretendon se me datë 08.02.2021, nga Inspektorët Komunal është bërë inspektimi dhe evidentimi i të gjitha pronave dhe bilbordave të vendosura në pronë publike dhe përgjatë rrugëve në Drenas, pa leje përkatëse për të cilat është hartuar raport i detajuar nga Inspektorët Komunal. Me këtë rast nga ana e këtij subjekti është bërë shkelja e nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një raport të detajuar nga Inspektorati Komunal dhe disa fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 11.02.2021, subjekti politik PDK, thekson se ankesa e parashtuar nga Drejtoria e Inspektionit të Komunës së Drenasit, nuk qëndron duke theksuar se pas kontakteve me Degën e PDK-së në Drenas, dhe kandidatëve për deputet të apostrofuuar

në ankesë, është konstatuar se kandidatët për deputet kanë marrëveshje me kompanitë e reklamave dhe përgjegjësia bie mbi ato kompani. Po ashtu në këtë ankesë përmenden edhe emra të deputetëve që nuk janë kandidatë të PDK-së. Lidhur me vendosjen e billboardave dhe posterave në pronat private, siç ceket në ankesë, kandidatët kanë marrëveshje me pronarët e këtyre objekteve ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu ka theksuar se PDK, me kohë i ka adresuar dhe kërkuar nga gjithë kandidatët për deputet strukturat mbështetëse dhe simpatizantët e Partisë, që ti përmbahen rregullatives ligjore për zhvillimin e fushatës zgjedhore.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ankesës së palës ankuese, së bashku me provat e bashkangjitura në të, përkatësisht raportin e detajuar Nr.11032-6078, e datës 09.02.2021 dhe fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, përgjigjën në ankesë, dhe provat e paraqitura me përgjigje në ankesë, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, erdhi në përfundim se ankesa e parashtruar nga Komuna e Drenasit – Drejtoria e Inspektionit, është pjesërisht e bazuar. Paneli e pranoi si të bazuar ankesën sa i përket kandidateve për deputet, Petrit Hajdari, Hyrije Xhemajlaj, Donjet Bislimi, Ferat Shala, Sejdi Hoxha, Shqipe Zogaj dhe Xhevahire Izmaqi, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterëve për fushatën zgjedhore në hapësira publike, pasi që për të njëjtit nuk është ofruar dëshmi se kanë pasur leje për vendosjen e billboardave dhe posterave.

Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, në përgjigjën në ankesë të datës 11.02.2021, ka ofruar dëshmi për disa kandidatë të cekur në ankesë, që të njëjtit kanë leje me kompani të ndryshme për vendosjen e billboardave dhe posterave. Posterët e vendosur nga kandidatet për deputet si në pikën -I-, të dispozitivit, që rezultojnë se janë vendosur në hapësira publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve*”.

Paneli kishte parasysh përgjigjen e subjektit politik PDK-se, që kishte bashkangjitur kontrata dhe marrëveshje për shfrytëzimin e konstruksioneve me qëllim të vënies së vendosjes së pllakateve, megjithatë paneli vlerëson se kontratat e tilla duke qenë se nuk mbështeteshin me asnjë leje të lëshuar paraprakisht nga organet e nivelit të pushtetit lokal që si të tilla ato konstruksione rezultojnë se janë të vendosura neper hapësira publike, e që shfrytëzuesit e këtyre konstruksioneve nuk rezultojnë se kishin leje për shfrytëzim, këto dëshmi për panelin nuk përbënin veprim të ligjshëm të shpërfaqjes së materialit për fushatën zgjedhore, siç kërkohet nga 33 pika b), e LZP-së. Për më tepër në pikën 8 të kontratës së lidhur, theksohet se, “për tere atë çka nuk është përshkruara në këtë material vlen ligji i republikës së Kosovës që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës”, çka për pasojë veprimet e tilla reflektojnë në raport me veprimet e kandidateve për deputet të subjektit politik PDK-ës.

Paneli për sa i përket pjesës refuzuese ka parasysh faktin se, ankesa ishte parashtruara nga ana e Inspektoratit të Komunës së Drenasit, e që rezulton se kandidatja për deputet Besa Çeku, sipas raportit të inspektoriatit kishte vendosur materialin si kandidatet në pjesën e pronës private, çka paneli vlerësoj se nuk pasqyrohet kushti ligjor sipas nenit 33 pika b) të LZP-së, për verifikimin e rrethanës nga ana e inspektoratit se a dispononte leje nga pronaret privat siç edhe ka konstatuar inspektorati, nga se kjo dispozite ka kushte për shkeljen kur nuk ekziston leja nga personat, provat për pronën private apo nuk ekziston leja nga personat që kanë në shfrytëzim hapësirën e tille privatë.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë u cilësuan si pjesërisht të bazuara në meritat e lëndës.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik PDK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, numrin e kandidateve të përfshirë në shkeljen dhe disa nga ta ne përsëritje të shkeljeve shkeljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 363/2021 më datën 12.02.2021

Kryesuesi i Panelit

Burim Adem

Burim Adem



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.